



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 396/23

PSH. Nr. 400/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërjen Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesën e operatorit ekonomik (OE) "Limitproject" sh.p.k. dhe ankesën e OE "N.P.N. Hidroterm sh.p.k. të parashtruara kundër Vendimit të datës 31.05.2023, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Projekt me bashkëfinancim -Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytë-ri tender" me numër të prokurimit 624-23-287-581, iniciuar nga Komuna e Suharekës në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK) me 10.08.2023, mori:

V E N D I M

- 1 Refuzohen si të pabazuara, ankesa e OE "Limit Project" sh.p.k. e datës 15.06.2023 (Nr. 2023/0396) dhe ankesa e OE "N.P.N. Hidroterm sh.p.k. e datës 15.06.2023 (Nr. 2023/0400), kurse mbetet në fuqi Vendimi i AK për dhënien e kontratës i datës 31.05.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Projekt me bashkëfinancim -Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi, faza e dytë-ri tender" i evidentuar me numër të prokurimit 624-23-287-58.
2. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sikurse parashihet me nenin 31 paragrafi 5, të Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me nenin 118 të LPP.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 31.01.2023, Komuna e Suharekës, duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Projekt me bashkëfinancim -Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi, faza e dytë-ri-tender" i evidentuar me numër të prokurimit 624-23-287-58.

Me 03.02.2023, AK (me të dhëna si më sipër) përmes publikimit, i ka informuar palët e interesuara lidhur me korrigjimin e gabimeve të cilat i referohen njoftimeve paraprakisht të publikuara, ndërsa hapja e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit është realizuar me 21.02.2023.

Me 31.05.2023, AK ka publikuar vendimin e tij/sajë për dhënie të kontratës, përkitazi me aktivitetin e prokurimit, i cili me datë, numër dhe emërtim është përshkruar tani më si më sipër.

Me 02.06.2023, OE si në vijim “Limitproject” sh.p.k. dhe OE “N.P.N. Hidroterm sh.p.k” kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim, të cilat janë refuzuar si të pa bazuara me Vendimin e AK të datës 09.06.2023.

Me 09.06.2023, të pakënaqur me vendimin e cituar si më sipër të AK për dhënie të kontratës, OE “Limitproject” sh.p.k dhe OE “N.P.N. Hidroterm sh.p.k” kanë parashtruar ankesë në OSHP.

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

OSHP ka konstatuar se ankesat në rastin konkret janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtrorë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesit kanë statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesat i përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.

Duke ju referuar ankesave si më sipër, përmbajtjes dhe qëllimit të tyre, konstatohet paraprakisht se lidhur me çështjen në rastin konkret, gjen zbatim neni 16 (Rastet e unifikuara) i Rregullores së cituar, sipas të cilit Kryetari i OSHP ka të drejtë që ti bashkoj Lëndët/ankesat të cilat në kuptimin e pretendimeve ankimore janë të lidhura me lëndën apo tenderin e njëjtë, mund të përfshihen në raportin e shqyrtimit fillestar nga i njëjti ekspert dhe ka të drejtë të vendos i njëjti Panel shqyrtues.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë konstatohet se:

→ Raporti i ekspertizës, i datës 03.07.2023, përmban rekomandimet si në vijim:

- Të refuzohet si e pa bazuar ankesa e OE “Limitproject” sh.p.k.
- Të anulohet Vendimi i AK i datës 31.05.2023 dhe Lënda të kthehet në rivlerësim;

→ Raporti i ekspertizës i datës 03.07.2023, përmban rekomandimet si në vijim:

- Të refuzohet si e pa bazuar ankesa e OE “N.P.N. Hidroterm sh.p.k”
- Të anulohet Vendimi i AK i datës 31.05.2023 dhe Lënda të kthehet në rivlerësim;

Raportet e ekspertizës i përmbajnë elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe të njëjtit janë pranuar nga palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se në të dyja rastet, AK është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues, në kuptimin që ankesa e OE “N.P.N. Hidroterm sh.p.k” të konsiderohet e pabazuar por nuk pajtohet që lënda të kthehet në ri-vlerësim. Ndërkaq ankuesit nuk janë pajtuar me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesat në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Në këtë rast Paneli mori paraprakisht konstatoi se AK ka zbatuar:

- a. procedurë të hapur, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.37. të nenit 4, të LPP;
- b. lloji i kontratës: Punë, sikurse parashihet me paragrafin 3, të nenit 27, të LPP;
- c. vlera e parashikuar e kontratës: 3,100.000.00 € vlere e madhe, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.28 të nenit 4, lidhur me paragrafin 1, të nenit 19, të LPP

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli shqyrtues (në përbërje kolegjiale) administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi si në vijim:

a) Pohimet ankimore të OE “Limitproject” sh.p.k

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cirkuar si më sipër të AK nga aspekti i eliminuar të tij/sajë se (sipas AK) plani dinamik i ankuesit nuk i ka plotësuar kërkesat e parashikuara me dosjen e tenderit (DT). Lidhur me këtë, në raportin e ekspertit shqyrtues konstatohet se ankuesi nuk e ka paraqitur planin dinamik me elementet e precizuara për secilin pozicion, ashtu sikurse janë parashikuar ato shprehimisht me DT. Në këtë rast, duke i analizuar dhe krahasuar pohimet ankimore në raport me ofertën, shpjegimet e ekspertit dhe kërkesat e DT, Paneli mbështeti shpjegimet e dhëna në raportin e ekspertizës andaj pohimi ankimor në këtë rast konsiderohet i pabazuar.

Ankuesi ka pohuar në vijim se, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një Letër referencë nga Banka në emër të CONSTRUMAX dhe EBK, sipas së cilës i njëjti (sipas ankuesit) nuk ka mjete të gatshme bankare dhe nuk do të ketë qasje në kredi. Duke i analizuar nga ky aspekt shpjegimet nga raporti i ekspertit dhe duke i krahasuar sërish të gjitha këto me DT, konstatohet se Kërkesa e DT përmban formulimin si në vijim, cituar: “Operatori Ekonomik duhet te ketë mjete financiare

te mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete te gatshme ne bankë në vlerë prej së paku 1,000,000.00 € ose dëshmi mbi akses ne kredi nga një Banke, për te njëjtën vlerë (1,000,000.00 €) në emër të të njëjtit aktivitet të prokurimit”. Kjo do të thotë (nga pikëpamja e Panelit) se sipas këtij kriteri dhe/ose kërkesë, nënkuptohet se OE i rekomanduar e ka plotësuar kërkesën e DT, përderisa për këtë aktivitet të prokurimit nuk është kërkuar që qasja në ndonjë kredi eventuale të jetë, cituar: “e pakushtëzuar” dhe rrjedhimisht pohimi ankimor në këtë rast kualifikohet si i pabazuar¹. PSH këtë e mbështet edhe në konsistencë të vendimeve tjera të PSH me nr. 494/22;495/22;497/22; 500/22;503/22;505/22; 510/22;547/22;548/22;600/22;810/22.

Në fakt, duke ju referuar aktivitetit të prokurimit për secilin rast, apriori konstatohet se kërkesat e vendosura në DT janë gjithnjë specifike, sepse ato formulohen si të tilla ashtu sikurse kërkohet me dispozitën e nenit 27 lidhur me nenin 28 të LPP, mirëpo hartimi i një DT (dhe kriteret e sajë) determinohen nga planifikimi paraprak i prokurimit dhe parashikimit të nevojave që duhen përmushur, sikurse kërkohet kjo me nenin 8 dhe 9 të LPP gjë që i takon pavarësisë institucionale të AK që aktivitetin e prokurimit ta inicioj dhe implementoj ashtu sikurse i ka publikuar të gjitha këto në DT. Prandaj kërkesa sikurse në rastin konkret (në kuptim të përkrahjes nga Bankat komerciale), mund të jetë e kushtëzuar dhe/ose e pakushtëzuar, mirëpo natyrisht se një kriter i tillë shprehimisht duhet të parashikohet si i tillë. Andaj AK në këtë rast nuk e ka vendosur në DT një kërkesë të pakushtëzuar dhe mbi këtë bazë nuk mund të mohohet fakti se, GOE të rekomanduar për kontratë, e ka plotësuar një kërkesë të tillë duke i prezantuar si pjesë përbërëse të ofertës dy Letra të cilat e konfirmojnë përkrahjen e tij (si klientit) lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Pa e mohuar faktin se (sikurse vërehet) OE i Rekomanduar dhe ankues i kanë të ngjashme letrat për përkrahje nga banka. Prandaj Paneli konsideron se me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderve AK ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 68 të LPP, lidhur me analizimin real të gjendjes ekonomike dhe financiare të ofertuesve.

Ankuesi ka pohuar po ashtu se OE të rekomanduar i mungon deklarata e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizimin e partnerit udhëheqës. Nga shikimi i shkresave të lëndës vërehet se GOE të rekomanduar për kontratë e ka marrëveshjen e konzorciumit, sipas të cilës e ka caktuar edhe përfaqësuesin e tyre autorizuar që ta përfaqësoj dhe ti nënshkruaj dokumentet e nevojshme në emër dhe për llogari të GOE, për realizimin e këtij projekti. Paneli konsideron se përderisa aki kontraktues në rastin konkret përmban një dispozitë të tillë, akti formal i autorizimit nuk është i përvojshëm të krijohet si dokument paralel dhe si rrjedhje marrëveshja e cituar i plotëson kushtet e kërkuar me nenin 71 të LPP. Ankuesi ka pohuar më tej se, pretendimi ankimor se GOE të rekomanduar për kontratë nuk e ka prezantuar stafin sipas kriterëve minimale, duke theksuar mes tjerash se (sipas biografisë/CV) menaxheri i emergjencave (me titullin bachellor) nuk e ka përvojën e duhur. Mirëpo nga sa vërehet kjo në shkresat e kësaj lënde, oferta e GOE i rekomanduar për kontratë ka ofruar numër të punëtoreve që tejkalon kërkesën dhe është konform kërkesave të përcaktuara në DT, përderisa lidhur me inxhinierin e përmendur më sipër, në fjalë Paneli e mbështetet e arsytimin e AK e cili ka konstatuar se Inxhinieri i emergjencave ka më shumë

¹ Vendimi dhe/ose kualifikimi ankimor në këtë rast, i referohet konsistencës së vendimeve për rastet tjera identike.

përvojë pune se tri (vite) pas diplomimit dhe kjo përvojë nuk ka qenë e domosdoshme sipas kërkesave të dosjes së tenderit që duhet të jetë vetëm në lëmin e emergjencave. Më tej, ankuesi ka atakuar vendimin e AK me pohimin se se GOE të rekomanduar për kontratë nuk e ka paraqitur deklaratën që dëshmon se mjetet të cilat janë të destinuara për përdorim janë në gjendje të mirë operacionale. Lidhur me këtë, Paneli Shqyrtues shpjegon se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, sepse zhjdhja e njërit prej tyre është kusht i domosdoshëm për realizimin e qëllimit të prokurimit. Paneli konsideron se ankesa nga ky aspekt nuk konsiderohet e bazuar sepse AK disponon me kapacitetin e mjaftueshëm profesional dhe organizativ për ta konstatuar një fakt i cili është fare elementar, nëse mjetet të cilat janë të destinuara për përdorim janë në gjendje të mirë operacionale apo jo. Në fakt, sipas paragrafit 1, të nenit 59 të LPP parashihet se, cituar: “Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”. Po ashtu, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Ankuesi ka pohuar po ashtu se oferta e GOE të rekomanduar për kontratë duhet të trajtohet si tender me vlerë jo normalisht të ulët, me ç’rast Paneli e mbështet në këtë rast shpjegimin e ekspertit shqyrtues i cili ka thekson se kriteri i dhënies ka qenë tender ekonomikisht më i favorshëm dhe se, cituar: “gjithë tenderët janë përafërsisht njësoj me çmim”. Prandaj sipas shpjegimeve si më sipër Paneli konsideron se edhe pohimet e cituara si më sipër nuk janë të bazuara.

Njëherit Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç’rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontratë konsiston në një çmim me të lirë në raport me ofertën e ankuesit dhe atë me diferencën prej 329,102.37 €. Ky fakt dhe një diferencë e tillë nuk mund të shmanget nga vëmendja e Panelit sepse sipas dispozitës së nenit 99, OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të këtij Ligji. OSHP ka autoritetin dhe përgjegjësitë e parashikuara dhe me nenin 104, paragrafi 1, sipas të cilit “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës në fjalë” dhe se “Zbatimi i ndonjë procedure të shqyrtimit dhe asnjë vendim i OSHP nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër”.

b. Pohimet ankimmnore të OE “N.P.N. Hidroterm sh.p.k”

Ankuesi (me shënime si më sipër) ka pohuar se është eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet i prokurimit duke i kontestuar thëniet e AK, se i njëjti nuk i ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertës pasi që AK me 23.05.2023, ka dërguar letër standarde për të gjithë pjesëmarrësit, andaj si e tillë

oferta duhet refuzuar. Ankuesi ka pohuar se nuk ka pranuar kurrfarë njoftimi nga AK për vazhdimin e validitetit të ofertave. Mirëpo, në raportin e ekspertit shqyrtues shpjegohet se kërkesa e AK e datës 23.05.2023 është pranuar nga të gjithë OE dhe të gjithë i janë përgjigjur kësaj kërkesë sepse nuk duket të jetë kjo e mundur që nga platforma e e-prokurimit, të anashkalohet vetëm njëri nga OE. Nga ana tjetër secili ka pasur kohë të mjaftueshme për t'ju përgjigjur kësaj kërkesë të AK. Paneli në këtë (pa nevojë për komente tjera) konsideron se AK ka vepruar në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 30.5 dhe 30.6, të RRPP Nr, 001/2022, lidhur me pragrafin 2 të nenit 59 të LPP dhe se, ankuesi objektivisht (sipas efektit të normave ligjore) e ka humbur statusin e palës në këtë çështje administrative, meqë nuk është përfshirë në statet tjera të prokurimit publik. Ky fakt, tani jo kontestues për panelin e transferon ankuesin në pozitën e palës “pa interes” sikurse përkufizohet kjo me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, gjë që kjo nënkupton një kusht të domosdoshëm edhe për staustin e tij ankimnor.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës, Paneli konstatoi se pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, i referohen në fakt nenit 41 (Njoftimi mbi Dhënien e Kontratës) të LPP, sipas të cilit autoriteti kontraktues ka dhënë përfundimisht një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura dhe duke i ndërmarrë një serë veprimesh të cilat parashihen shprehimisht me LPP, pa nevojë që të njëjtat të përshkruhen në këtë rast. Kurse (sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës) pretendimet ankimore apriori nuk konsistojnë në faktin nëse është atakuar apo jo interesi ekonomik i Ankuesit, por ato atakojnë shkaqet dhe arsyet mbi bazën e të cilave AK, ka rekomanduar për kontratë një tjetër OE. Mirëpo pavarësisht nga kjo, duhet shpjeguar se parashtruesi i ankesës nuk ka të drejtë ta fitoj sërish, (në këtë fazë) statusin e palës me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4, të Ligjit të cituar, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritore të pohimeve specifike të kësaj Ankesë, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP. Njëherit Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontratë konsiston në një çmim me të lirë në raport me ofertën e ankuesit dhe atë me diferencën prej 329,102.37 €.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se pohimet ankimore nuk janë të bazuar, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 7, 59 dhe 60 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit në ri-vlerësim, pa fakte dhe prova jo kontestuese dhe/ose pa bazë ligjore, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi, Kryetar



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK- Komuna Suharekë
- OE ankues
- Arkivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe zyrtare;